



**Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština - Assembly**

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut , Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione
Prishtinë me 13 shkurt 2008 në orën 13,00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V R B A L

**I mbledhjes se Komisionit për të Drejtat e Njeriut ,Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione , të mbajtur më 13 shkurt 2008**

Në mbledhje morën pjesë : Ismet Beqiri, kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviç, Nerxhivane Dauti, Naim Rrustemi, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Vezira Emrush, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati anëtarë.

Në mbledhje ishin të pranishëm :

Lejla Selimi nga OSBE-ja
Nexhat Shatri nga Presidenca

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri kryetar dhe propozoi këtë :

R e n d i t e

1. Mbledhja konstituive e Komisionit

Rendi i ditës u miratua

U hap shqyrtimi për pikën e parë

1. Mbledhja konstituive e Komisionit

Kryetari, pasi që i përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe u dëshiroi mirëseardhje, nënvizoi : Nga titulli i Komisionit keni vërejtur se cilat fusha të veprimit i përfshin Pastaj ceku se ne mesin tonë ka disa anëtarë edhe nga legjislatura e kaluar që kanë përvojë, kështu që kjo është një ndihmesë për Komisionin. Fushëveprimtaria e Komisionit bazohet në katër fusha përkatësisht shtylla, të cilat janë të rëndësishme për punën e Kuvendit të Kosovës e këto janë : të drejtat e njeriut, barazia gjinore, personat e pagjetur dhe peticionet. Në vazhdim kryetari tha se gjatë punës së Komisionit të gjithë

anëtarët e tij do të jenë të barabartë, kurse për udhëzimet eventuale ose për çështje të natyrës procedurale teknike mund t'i drejtoheni Rrahim Demës – zyrtar i lartë për mbështetje të këtij komisioni.

Ndër te tjera kryetari kërkoi nga anëtarët e Komisionit që t'i përgatisin me kohë planet operative të punës.

Hajredin Hyseni vuri në pah: Nuk do të shtoja më shumë, sepse morëm informacionet e duhura nga kryetari. Suksesi ynë në të ardhmen do të varet nga puna e përbashkët e Komisionit në fushëveprimtarinë që mbulon dhe veçmas kur Kosova po bëhet shtet.

Sanije Alijaj –duke u ndërlidhur me parafolësit sa u përket personave të pagjetur shtoi se Komisionit përkatës i mungon ministria që do t'i zbatonte vendimet e marra. Pra, do të kërkojmë që plani i punës të zbatohet në fushat që kanë të bëjnë me liritë dhe drejtat e njeriut, personat e pagjetur dhe do kemi bashkëpunim me OJQ-të që merren me personat e pagjetur ngase kjo është aktuale .

Ibrahim Makolli ua përkujtoi të pranishmëve se në demokracitë e zhvilluara komisionet e tilla nuk marginalizohen, por zënë vende kryesore në parlamentet e tyre. Ai ishte i mendimit se projektligjet e ofruara nga Qeveria do shqyrtohen nga këto komisione. Mirëpo sipas tij, duhet ta përshpejtomë punën, sepse kemi ngecje sa i përket zbardhjes së fatit të personave të pagjetur .

Dr. Nerxhivane Dauti – vuri në dukje se në legjislaturën e mëparshme ka pasur mangësi. Ajo u pajtua me parafolësit dhe njëherit i propozoi Komisionit që në fushën e personave të pagjetur të ndërmerret nisma për hartimin e projektligjit, sepse me këtë do të mbulohej vakumi ligjor që ekziston te familjet e të zhdukurve. Me propozimin e saj u pajtua edhe Ibrahim Makolli. Ajo foli për përvojën që ka nga legjislaturat e mëparshme në zgjedhjen e peticioneve dhe ceku se ka kërkuar që serish të jetë në këtë komision. Ishte konstatim unanim që mbledhjet e Komisionit të mbahen rregullisht dhe në to të zhvillohen debate konstruktive. Në fund Komisioni, lidhur me këtë pikë nxori këtë:

P e r f u n d i m

I. Secili anëtar t'i hartojë pikat e planit të punës dhe t'ia paraqesë Rrahim Demajt, që do t'ua dorëzojë anëtareve të Komisionit, me qëllim që para mbledhjes së radhës të njoftohen për planin e punës që do të miratohet në njëërën nga mbledhjet e ardhshme.

II. Komisioni u pajtua që gjatë muajt të mbahen dy mbledhje dhe për këtë do të angazhohen grupet punuese.

Procesverbalin e hartoi
Rrahim Demaj – zyrtar i lartë

Kryetari i Komisionit
Ismet Beqiri